Njësia 105	RO Gjilan	GN011	GN011/104	N.Sh Pasuria Bujqësore	Pasuria Bujqësore Toka në Rahovicë (Lot 01)	tokë bujqësore	[illegible]	Ferizaj	Rahovicë	1	1399	0	0	2	0.1	02338-0				Aprovuar	ARË	1994.88	Pronë për objekt rezidencial	32788	74	Aprovuar		3000	3000	3000
Njësia 106	RO Gjilan	GN024	GN024/18	K.B Zhegra	K.B Zhegra Toka në Lladovë (LOT I)	arë	[illegible]	Gjilan	Lladovë	1	2142	0	0	2	0.21	02095-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	21764	Pronë komerciale - për objekt komercial	25704	73	Aprovuar		1200	3000	2000
Njësia 107	RO Gjilan	GN024	GN024/18	K.B Zhegra	K.B Zhegra Toka në Lladovë (LOT C1)	arë	[illegible]	Gjilan	Lladovë	1	3436	0	0	2	0.34	02129-0	02271-0			Aprovuar	ARË	3087.6	Pronë komerciale - për objekt komercial	23232	74	Aprovuar		1250	3000	3000
Njësia 108	RO Gjilan	GN024	GN024/23	K.B Zhegra	K.B Zhegra Toka në Zhegër (LOT 0C)	arë	[illegible]	Gjilan	Zhegër	1	131	0	0	2	0.03	02957-0				Aprovuar	ARË	294.6	Pronë komerciale - për objekt komercial	294.6	74	Aprovuar		60	1000	1000
Njësia 109	RO Gjilan	GN028	GN028/27	K.B Agroprodukt	Agroprodukt toka në Pançelë (LOT 01)	livadh	[illegible]	Kamenicë	Pançelë	1	2040	0	0	2	0.1	02091-0				Aprovuar	ARË	1257.6	Pronë komerciale - për objekt komercial	1257.6	74	Aprovuar		120	1500	1000
Njësia 110	RO Gjilan	GN035	GN035/80	N.B.I Agromorava	NBI Agromorava_Toka në Sadovinë të Çerkezëve (Lot F)	lëndinë	[illegible]	Viti	Sadovinë e Çerkezëve	2	6754	0	0	2	0.89	02716-0	02717-0			Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	10884.0	Pronë komerciale - për objekt komercial	10884.0	73	Aprovuar		120	1000	1000
Njësia 111	RO Gjilan	GN035	GN035/89	N.B.I Agromorava	NBI Agromorava_Toka në Viti (Lot H)	arë	[illegible]	Viti	Viti	1	907	0	0	2	0.09	02839-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	4334.4	Pronë komerciale - për objekt komercial	4334.4	73	Aprovuar		480	1000	1000
Njësia 112	RO Gjilan	GN033	GN035/73	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Budrikë e Epërme (LOT C)	arë	[illegible]	Viti	Budrikë e Epërme	1	4499	0	0	2	0.45	02858-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	9027.88	Pronë komerciale - për objekt komercial	9027.88	73	Aprovuar		117	1000	1000
Njësia 113	RO Gjilan	GN035	GN035/84	N.B.I Agromorava	Agromorava Toka në Viti (Lot 01)	arë	[illegible]	Viti	Viti	1	5621	0	0	2	0.56	02482.2				Aprovuar	Pronë për objekt rezidencial	222744	Pronë komerciale - për objekt komercial	222744	74	Aprovuar		6400	18000	18000
Njësia 114	RO Gjilan	GN018	GN018/15	K.B Morava Partesh	K.B Morava Partesh Toka në Partesh (LOT 02)	arë	[illegible]	Partesh	Partesh	1	8179	0	0	2	0.82	01122-0				Aprovuar	ARË	16866	Pronë komerciale - për objekt komercial	16866	74	Aprovuar		300	3000	3000
Njësia 115	RO Mitrovica	MIT022	MIT022/38	Agrokultura	Agrokultura parcela 902-0 Selac	tokë	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Selac	1	7700	0	0	0	0.77	02271-0				Aprovuar	ARË	3000.15						25	1000	1000
Njësia 116	RO Mitrovica	MIT022	MIT022/77	Agrokultura	KB Agrokultura Lokali në Shipol	objekt	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Sh. Dardanët e Lindjes, Shipol	0	0	1	60	0				Tregtia në Shipol		Aprovuar	Objekt tjetër komercial	10400					640		4000	4000
Njësia 117	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/92	Produkt	Produkt Parcela 413-5 në ZK Polac i Vjetër	arë	[illegible]	Skenderaj	Polac	1	7636	0	0	0	0.76	02313-5				Aprovuar	ARË	13704.6		13704.6				185	1000	1000
Njësia 118	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/30	Produkt	Tokë Bujqësore në Vitak- parcela 56-0	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Fshati Vitak	1	4510	0	0	10	0.46	02256-0				Aprovuar	ARË	5080.16	Pronë komerciale - për objekt komercial	5080.16	Liquidation Asset Sale 11, Liquidation Asset Sale 24, Liquidation Asset Sale 32	Aprovuar		113	1000	1000
Njësia 119	RO Mitrovica	MIT044	MIT044/5	Trepçamens	Objekt dhe Garazha e Trepçamens në Zhabar të Epërm	depo	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Zhabar i Epërm	0	0	1	2706.5	2				Ovqertë		Aprovuar	Objekt	164366	Objekt	564166	74	Aprovuar	304		20000	20000
Njësia 120	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/32	Produkt	Produkt Toka në Sakegatë Parcela 702-0	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Sakegatë	1	7820	0	0	1	0.79	02797-0				Aprovuar	ARË	8879.36	Pronë komerciale - për objekt komercial	8879.36	Liquidation Asset Sale 11, Liquidation Asset Sale 26, 29, Liquidation Asset Sale	Aprovuar		112	3000	1000
Njësia 121	RO Mitrovica	MIT044	MIT044/6	Trepçamens	Depo e vjetër e Trepçamens në Zhabar të Epërm	objekt i përbashkët	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Fshati Zhabar i Epërm	0	3000	1	1029	3	0.6			Depo		Aprovuar	Objekt	967617.9	Objekt	967617.9	73, 74	Aprovuar	117.7	13770	40000	40000
Njësia 122	RO Mitrovica	MIT044	MIT044/8	Trepçamens	Depo e vogël e Trepçamens në Zhabar të Epërm	depo	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Fshati Zhabar i Epërm	0	0	1	228.7	2				Depo		Aprovuar	Depo	40042.8	Depo	40042.8	74	Aprovuar	204		3000	3000
Njësia 123	RO Mitrovica	MIT022	MIT022/22	Agrokultura	Agrokultura Depo në Bare	objekt	[illegible]	Mitrovicë e Jugut	Fshati Bare	0	0	1	167	21				Depo		Aprovuar	Depo	22040	Depo	22040	Liquidation Asset Sale 15, Liquidation Asset Sale 22, Liquidation Asset Sale 36	Aprovuar	120		3000	2000
Njësia 124	RO Mitrovica	MIT002	MIT022/3	KB Prelluzha	KB Prelluzha Parcela 00118-0	tokë bujqësore	[illegible]	Vushtrri	Prelluzhë	1	4725	0	0	14	0.47	02518-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	94503	Pronë komerciale - për objekt komercial	94503	Liquidation Asset Sale 64, Liquidation Asset Sale 67, Liquidation Asset Sale 68	Aprovuar		3000	3000	9000
Njësia 125	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/30	Produkt	Produkt Toka në Burojë 4	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Burojë	1	4497	0	0	9	0.45	01167-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	3036.64	Pronë komerciale - për objekt komercial	17982	Liquidation Asset Sale 13, Liquidation Asset Sale 22, Liquidation Asset Sale 40	Aprovuar		400	1000	2000
Njësia 126	RO Mitrovica	PRN021	PRN021/41	K.B. Drenica	Parcela 00328-0 në Pollatë	tokë bujqësore	[illegible]	Gllogoc	Pollatë	1	2710	0	0	10	0.17	02028-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	13062.8	Pronë komerciale - për objekt komercial	13062	Liquidation Asset Sale 13, Liquidation Asset Sale 24, Liquidation Asset Sale 27	Aprovuar		480	3000	3000
Njësia 127	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/58	Produkt	Produkt Parcela 00139-0 në Çitak	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Çitak	1	6322	0	0	2	0.23	02139-0				Aprovuar	ARË	9196	Pronë komerciale - për objekt komercial	53788	Liquidation Asset Sale 37, Liquidation Asset Sale 40, Liquidation Asset Sale 46	Aprovuar		730	1000	6000
Njësia 128	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/185	Produkt	Ngastra 3064-0 në ZK Klinë e Epërme	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Klinë e Epërme	1	2251	0	0	3	0.22	02266-0				Aprovuar	Pronë për objekt rezidencial	229093.2	Pronë komerciale - për objekt komercial	2303.2	72, 74	Aprovuar		1300	3000	3000
Njësia 129	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/186	Produkt	Produkt Parcelat 564-0 dhe 565-0 në Makërmal	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Makërmal	2	7441	0	0	2	0.34	02964-0	02213-0			Aprovuar	ARË	9134.46	Pronë komerciale - për objekt komercial	98530	74	Aprovuar		600	1000	6000
Njësia 130	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/187	Produkt	Produkt Parcelat 1653-3 dhe 1654-0 në Makërmal	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Makërmal	2	4770	0	0	2	0.66	02723.2	02934-0			Aprovuar	ARË	8885.6	Pronë komerciale - për objekt komercial	54100	74	Aprovuar		840	8000	9000
Njësia 131	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/189	Produkt	Certifikata e Pronësisë dhe Ngastra e Planit	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Makërmal	1	6081	0	0	2	0.64	02782-0				Aprovuar	ARË	7706.24	Pronë komerciale - për objekt komercial	46684	74	Aprovuar		860	1000	5000
Njësia 132	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/200	Produkt	Tokë Bujqësore në Vojnik parcela 118-0 dhe 179-0	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Vojnik	2	9440	0	0	2	0.94	02519-0	02579-0			Aprovuar	ARË	10572.8	Pronë komerciale - për objekt komercial	10572.8	74	Aprovuar		112	1000	1000
Njësia 133	RO Mitrovica	PRN081	PRN081/80	K.B. Drenica	Drenica Parcela 171-0 në Sankoc	tokë bujqësore	[illegible]	Gllogoc	Sankoc	1	2994	0	0	2	0.3	02871-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	5251.64	Pronë komerciale - për objekt komercial	5251.64	73	Aprovuar		176	1000	3000
Njësia 134	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/111	Produkt	Ngastra 00643-0 në ZK Baj	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Baj	1	9984	0	0	2	0.48	02842-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	6708.56	Pronë komerciale - për objekt komercial	6708.56	73	Aprovuar		132	8000	1000
Njësia 135	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/112	Produkt	Ngastra 00733-0 në ZK Baj	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Baj	1	9832	0	0	2	0.51	02072-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	5681.76	Pronë komerciale - për objekt komercial	5681.76	73	Aprovuar		113	8000	1000
Njësia 136	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/113	Produkt	Ngastra 00685-0 ZK Baj	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Baj	1	6362	0	0	2	0.64	02582-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	7114.24	Pronë komerciale - për objekt komercial	7114.24	73	Aprovuar		113	1000	8000
Njësia 137	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/114	Produkt	Ngastrat 2361-0 dhe 2362-0 ZK Baj	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Baj	2	6130	0	0	2	0.62	02361-0	02212-0			Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	9217.6	Pronë komerciale - për objekt komercial	9217.6	73	Aprovuar		113	8000	3000
Njësia 138	RO Mitrovica	MIT008	MIT008/115	Produkt	Ngastra 00023 ZK Baj	tokë bujqësore	[illegible]	Skenderaj	Baj	1	1846	0	0	2	0.11	02023-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	1843.37	Pronë komerciale - për objekt komercial	1843.37	73	Aprovuar		117	1000	1000
Njësia 139	RO Mitrovica	MIT012	MIT012/115	Elan	Ngastra 01178-0 në ZK Dubovc	tokë bujqësore	[illegible]	Vushtrri	Dubovc	1	8444	0	0	2	0.85	01178-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	28307.2	Pronë komerciale - për objekt komercial	28337.2	73	Aprovuar		128	3000	3000
Njësia 140	RO Mitrovica	MIT012	MIT012/116	Elan	Ngastra 01212-0 në ZK Dubovc	tokë bujqësore	[illegible]	Vushtrri	Dubovc	1	7710	0	0	2	0.77	01212-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	5865.88	Pronë komerciale - për objekt komercial	5865.68	73	Aprovuar		78	1000	1000
Njësia 141	RO Pejë	PEJ013	PEJ013/3	KB Burimi	Parcela nr.177-2 dhe 177-3 ZK [illegible]	tokë bujqësore	[illegible]	Istog	ZK [illegible]	2	7750	0	0	3	0.38	00177-3	02177-3			Aprovuar	Pronë për objekt rezidencial	75388.02	Pronë komerciale - për objekt komercial	81764.2	72, 74	Aprovuar		1080	8000	8000
Njësia 142	RO Pejë	PEJ038	PEJ038/3	KB Lirta	Parcela nr.8-1 ZK [illegible]	tokë bujqësore	[illegible]	Klinë	ZK [illegible]	1	6850	0	0	2	0.88	00336.1				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	9970.2	Pronë komerciale - për objekt komercial	9878.2	72	Aprovuar		144	3000	1000
Njësia 143	RO Pejë	PEJ039	PEJ039/4	KB Shtupel	Parcelat nr. 576-1, 576-2 dhe 576-3	objekt i përbashkët	[illegible]	Klinë	ZK Shtupel	8	6753	0	0	4	0.06	00578-1	00578-2			Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	92272.4	Pronë komerciale - për objekt komercial	92272.4	Liquidation Asset Sale 30, Liquidation Asset Sale 22, 73	Aprovuar		1080	9000	9000
Njësia 144	RO Pejë	PEJ036	PEJ036/59	KB Dubrava	Parcelat nr.1345-1, 1345-2 dhe 1345-3 në ZK [illegible]	tokë bujqësore	[illegible]	Istog	ZK [illegible]	3	3670	0	0	7	0.27	01349-1	01349-2			Aprovuar	ARË	2394	ARË	3334	Liquidation Asset Sale 64, Liquidation Asset Sale 67, Liquidation Asset Sale 68	Aprovuar		120	1000	1000
Njësia 145	RO Pejë	PEJ036	PEJ036/61	KB Dubrava	Parcela 679-0 në ZK [illegible]	tokë bujqësore	[illegible]	Istog	ZK [illegible]	1	40	0	0	4	0	00679-0				Aprovuar	Pronë komerciale - për objekt komercial	1130	Pronë komerciale - për objekt komercial	1120	Liquidation Asset Sale 68, Liquidation Asset Sale 69, 71	Aprovuar		2300	1000	1000
Njësia 146	RO Pejë	PEJ013	PEJ013/18	Fabrika e Birrës	[illegible] e Transportit	objekt	[illegible]	Pejë	Pejë	0	0	1	309	2				Njësia e Transportit		Aprovuar	Objekt	95172	Objekt	95172	73, 74, 75	Aprovuar	300		10000	10000

H.N

Nr. Ref. BD-237/42

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për inicimin e procesit të shitjes direkte të sipërfaqes tokësore prej 210 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 01791-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 16047 m², ZK Pleshinë, komuna Ferizaj, pronë e GJI011 NSh Pasuria Bujqësore, me parashtruesin**

II. **Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.**

III. **Aprovohet kërkesa për inicimin e procesit të shitjes direkte të sipërfaqes tokësore prej 228 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 01791-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 16047 m², ZK Pleshinë, komuna Ferizaj, pronë e GJI011 NSh Pasuria Bujqësore, me parashtruesin**

IV. **Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin III të këtij vendimi është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.**

V. **Refuzohet kërkesa për inicimin e procesit të shitjes direkte të sipërfaqes tokësore prej 133 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 01791-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 16047 m², ZK Pleshinë.**

VI. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Pasuria Bujqësore, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti sipas paragrafëve I dhe III për sipërfaqen tokësore i plotësojnë kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me paragrafin V te dispozitivit Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se kërkesa e parashtruar për sipërfaqen 133 m2 nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores dhe po ashtu duke pas parasysh nenin 7.11 të rregullorës, sepse sipërfaqja prej 133m2 nuk është në posedim fakti brenda rrethojës së oborrit të shtëpisë dhe duke qenë se në atë pjesë të ngastrës nuk ka ndërtim si rast nuk bie në kategorinë e aseteve specifik dhe kësisoj Bordi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/43

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për inicimin e procesit të shitjes direkte të sipërfaqes tokësore prej 464 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 27729 m², ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e GJI035 NSh Agromorava, me parashtruesin**
II. **Klasifikimi i pronës të paraqitur në paragrafin I të këtij vendimi është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.**
III. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1100 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 27729 m², ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e GJI035 NSh Agromorava, me parashtruesin**
IV. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet inicimi i procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh se rasti sipas paragrafëve I dhe II për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4.1.2 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me paragrafin III te dispozitivit pas parasysh se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e ka bazuar në faktin se ka theksuar se pjesën prej 1100 m² aktualisht e shfrytëzon për objekt ndihmës dhe parking për automjete si dhe kënd lojërash për fëmijë.

Është me rëndësi të ceket se në mes të këtyre dy sipërfaqeve (në paragrafi I dhe III) kalon rruga publike e cila i ndan këto sipërfaqe tokësore. Pala deklaron se në këtë parcelë përveç ndërtimit të shtëpisë janë bërë edhe investime në shtrimin e asfalti, shtylla për përçuesit elektrik, janë mbjell pemë frutore, është bere gjelbërimi si dhe mbrojtja nga hedhja e mbeturinave në këtë parcelë. Të dy këto sipërfaqe që kërkohen të blihen nga pala, pozicioni i tyre gjeografik dhe shtrirja e tyre është drejtpërdrejt me shtëpinë e palës.

Rrjedhimisht Bordi ka konstatuar se pjesa prej 1100 m² nuk bie në kategorinë e asetit specifik dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/44

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për inicimin e procesit të shitjes direkte të sipërfaqes tokësore prej 1334.4 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 70403013-01281-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1644 m², ZK Gjilan, komuna Gjilan, pronë e GJI004 NSh Agrokultura, me parashtruesin**
II. **Klasifikimi i pronës sipas sipërfaqes prej 30 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1334.4 m² është pronë komerciale ndërsa kategoria është parcelë për objekt komercial.**
III. **Klasifikimi i pronës sipas sipërfaqes prej 1304.4 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 1334.4 m² është pronë rezidenciale ndërsa kategoria është parcelë për shtëpi familjare.**
IV. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin rekomandohet aprovimi i inicimit të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agrokultura, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë, dhe duke qenë se rasti për sipërfaqen tokësore i plotëson kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4.1.2 dhe nenit 4.1.3 të Rregullores Nr. 04/2024, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-237/45

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 4338 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 634-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 166341 m2, ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori, me parashtruesin**

II. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1499 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 635-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 32226 m2, ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori, me parashtruesin**

III. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 6 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 636-0, me sipërfaqe të përgjithshme prej 15783.8 m2, ZK Dushanovë. komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori, me parashtruesin**

IV. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e ka bazuar në faktin se sipas tij këto pjesë të këtyre tri ngastrave kadastrale i ka në shfrytëzim prej vitit 1990 së bashku me anëtaret e familjes së tij dhe të cilat i shfrytëzojnë për nevoja bujqësore. Pala ka theksuar se lidhur me këto ngastra ka pasur të lidhur kontratë interne mbi shfrytëzimin e kësaj paluajtshmërie e cila kontratë sipas tij i mungon tani për shkak të djegies së shtëpisë si pasoje e rrethanave të luftës në Kosovë.

Në mbështetje te kërkesës se tij pala pa paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike përmes se cilës ka shpjeguar dhe prezantuar pretendimet e tij për blerjen e pjesëve nga ngastrat kadastrale P. Nr.634-1; P. Nr.636-0 dhe 635-1 ZK Dushanovë pronë e NSh KBI Progres, Prizren.

Parcelat gjenden në ZK Dushanovë në Komunën e Prizrenit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për aktivitetete të ndryshme dhe ato bujqësore. Në këto prona aktualisht pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike të dorëzuar nga vet pala nuk ka fare ndërtim dhe te njëjtat kane qasje direkte në rrugë publike si tërësi te tyre. Edhe ngastra kadastrale 636-0 ka qasej në rrugë përmes ngastrave P. Nr.634-1 dhe 635-1 që po ashtu janë ngastra të së njëjtës NSh.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se është shfrytëzues i pronës që prej 1990. Në parcela që janë objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-237/46

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 27729 m2 dhe parcelës kadastrale nr 01329-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 385 m2, ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, prona të GJI035 NSh Agromorava, me parashtruesin**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e ka bazuar në faktin se sipas tij dëshiron ta blejë këtë pronë me qëllim rregullimin e Parkut për qytetarët e fshatit Stubëll si dhe një investim kënd me lodra për fëmijë. Në kërkesë nuk është dhënë asnjë arsyetim apo përshkrim tjetër lidhur me këtë pretendim.

Pala në mbështetje të kërkesës nuk ka bashkangjitur ndonjë ekspertizën gjeodezike për të elaboruar me saktësi pretendimet e tij, përveç se ka bashkangjitur ortofoto nga gjeoportali i Kosovës si dhe kopjen e planit lidhur me këto ngastra.

Parcela gjendet në ZK Stubëll e Epërme në Komunën e Vitisë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për veprimtaritë të ndryshme si bujqësore dhe po ashtu edhe biznesi me aktivitete të ndryshme dhe e njëjta ka një sipërfaqe të madhe prej 2.7 ha e cila gjendet pothuajse në mesin e fshatit Stubëll. Në këtë parcelë sipas ortofotos se dorëzuar nga pala dhe pamjeve të gjeoportalit e njëjta ka qasje nëpër rrugë, në faktë rruga e emëruar Anton Qeta kalon në këtë ngastër dhe në të shihet se ka disa ndërtime mirëpo nuk janë në posedim apo shfrytëzim te parashtruesit te kërkesës. Agjencia ka disa kërkesa të personave fizik lidhur me pjesë të kësaj ngastre.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se dëshiron ta rregulloj parkun dhe të bëj kënd për lojëra. Në parcela që janë objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/47

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 01330-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 27729 m2, ZK Stubëll e Epërme, komuna Viti, pronë e GJI035 NSh Agromorava, me parashtruesin**
II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh Agromorava, me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e ka bazuar në faktin se sipas tij parcela në fjalë kufizohet pra gjendet përpara pronave të prindit të tij. Pala ka theksuar se lidhur me këtë ngastër, nëse nuk i mundësohet shitja direkte, i njëjti do të kërkoj që pronën në fjalë ta marr me qira të cilën mendon ta shfrytëzoi për qellim të mbjelljes së fidanëve dhe pemëve të ndryshme.

Pala ka bashkangjitur një ortofoto dhe certifikatë prone, në të cilat vërehet se nuk ka ndonjë ndërtim në paluajtshmërinë në fjalë. Parcela gjendet në ZK Stubëll e Epërme, komuna e Vitisë dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për aktivitete të ndryshme.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se kufizohet me pronat e prindit të palës. Në parcelë që është objekt kërkese nuk ka ndërtim. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/48

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 947.4 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 00370-2, me sipërfaqe të përgjithshme prej 12686 m2, ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori me parashtruesin**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala në kërkesën e tij vetëm ka shprehur interesimin për të blerë këtë pjese te ngastrës kadastrale 00370-2, duke mos dhënë fakte apo shpjegime tjera në kërkesë. Në mbështetje të kërkesës pala ka bashkangjitur ekspertizën gjeodezike si dhe skicat përkatës të saj.
Parcela gjendet në ZK Dushanovë në Komunën e Prizrenit në të cilën në pjesën dërmuese të saj ka shtëpi banimi të ndërtuara. Pjesa e ngastrës kadastrale objekt i kërkesës nga pala aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike dhe nuk ka ndërtim dhe të njëjtat kanë qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se dëshiron ta blej. Në parcelë që është objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/49

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 9408 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 656-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 785074.8 m2, ZK Dushanovë, komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori me parashtruesin**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres – Lavërtari Blegtori me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.
Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e tij e ka bazuar në faktin se sipas tij është shfrytëzues i kësaj pjese të ngastrës kadastrale qysh nga vitet 1980 dhe e njëjta shfrytëzohet për mbjelljen e kulturave të ndryshme bujqësore. Pala ka theksuar se këtë pjesë të ngastrës e shfrytëzon pa u penguar nga askush. Pala ka paraqitur edhe ekspertizën gjeodezike përmes së cilës ka shpjeguar dhe prezantuar pretendimet e tij për blerjen e pjesës nga ngastrat kadastrale P. Nr.656-1.
Parcela gjendet në ZK Dushanovë në Komunën e Prizrenit dhe ka një pozitë shumë të përshtatshme për aktivitetet te ndryshme përfshi ato bujqësore. Në këtë pronë aktualisht pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike të dorëzuar nga vet pala nuk ka fare ndërtim dhe te njëjtat kane qasje direkte në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se e ka në shfrytëzim nga vitet 1980. Në parcelë që është objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/50

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 147-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 646 m2, ZK Ratkoc, komuna Rahovec, pronë e PRZ011 NSh NBI Rahoveci me parashtruesin**
II. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 1377-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 1138 m2, ZK Ratkoc, komuna Rahovec, pronë e PRZ011 NSh NBI Rahoveci me parashtruesin**
III. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 1588-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 958 m2, ZK Ratkoc, komuna Rahovec, pronë e PRZ011 NSh NBI Rahoveci me parashtruesin**
IV. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të parcelës kadastrale nr. 2044-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 374 m2, ZK Ratkoc, komuna Rahovec, pronë e PRZ011 NSh NBI Rahoveci me parashtruesin**
V. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh NBI Rahoveci me parashtruesin

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha ato që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e tij e ka bazuar në pretendimin se sipas tij këto prona kanë qenë trashëgimi e kahershme e familjes së tij dhe të njëjtat padrejtësisht janë të marra me një kontratë që nuk është nënshkruar nga prindi i tij e lidhur në vitin 1964 nen kërcënimin e shteti policor të ish-Jugosllavisë. Pala ka theksuar se që nga atëherë e deri me sot që mbi 50 vite është në shfrytëzim dhe posedim të të njëjtave parcela dhe se nuk ka qenë i penguar nga askush për shfrytëzimin e lirë të tyre.

Pala ka paraqitur edhe ekspertizën gjoedezike përmes se cilës ka shpjeguar dhe prezantuar pretendimet e tij për blerjen e pjesëve nga ngastrat kadastrale . Nr. 147-0; 1377-0; 1588-0 dhe 2044-0. Parcelat gjenden në ZK Ratkoc në Komunën e Rahovecit dhe kanë një pozitë shumë të përshtatshme për aktivitetet të ndryshme kryesisht bujqësore e që i njëjti i punon për nevoja të tij bujqësore. Në këto prona aktualisht pamjeve të gjeoportalit dhe ekspertizës gjeodezike të dorëzuar nga vet pala nuk ka fare ndërtim dhe të njëjtat kanë qasje direkte në rrugë si tërësi të tyre.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se e ka në shfrytëzim nga vitet 1964. Në parcela që janë objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-237/51

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 1300 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 00881-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11082.8 m2, ZK Llapllasellë, komuna Graçanicë, pronë e PRN115 NSh KBI Kosova Export - Ratar parashtruesen**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Kosova Export - Ratar parashtruesen

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.
Duke marr parasysh të gjitha atc që u cekën më lartë duke qenë se Bordi gjatë shqyrtimit të kësaj çështje juridike konstatoi se rasti nuk i plotëson asnjë nga kushtet për inicim të procedurës së shitjes më negocim direkt sipas nenit 4 të Rregullores, duke qenë se pala kërkesën e tij e ka bazuar në faktin se sipas tij kjo pjesë e ngastrës kadastrale kufizohet me pronën private e cila është në pronësi të palës së interesuar për blerje dhe të njëjtën dëshiron ta blej përmes procesit të shitjes direkte. Pala ka theksuar se lidhur me këtë pjese të ngastrës kadastrale nuk ka të interesuar tjerë që të njëjtën ta privatizojnë. Pala nuk ka bashkangjitur ekspertizë gjeodezike, vetëm një ortofoto dhe certifikatë të pronës private.

Parcela gjendet në ZK Llapllasellë në Komunën e Graçanicës. Në këtë pjese të parcelës aktualisht sipas pamjeve të gjeoportalit nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Mirëpo në një pjesë te saj ka edhe ndërtim të shtëpive, por jo të palës e dhe pjesa tjetër dërmuese e saj është e lirë pa ndërtime dhe me qasje në rrugë.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës është konstatuar se nuk ka bazë të mjaftueshme për inicimin e procedurës për shitje direkte vetëm me arsyetimin se e ka në shfrytëzim nga vitet 1964. Në parcela që janë objekt kërkese nuk ka ndërtim dhe ka qasje në rrugë. Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.
Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/52

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115, si dhe Rregullores Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet inicimi i procedurës për shitje direkte të sipërfaqes tokësore prej 8326 m² pjesë e parcelës kadastrale nr. 670-1, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1048195.7 m2, ZK Sërbicë e Poshtme, komuna Prizren, pronë e PRZ009 NSh KBI Progres – Lavertari Blegtori me parashtruesin dhe të tjerët.**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Raportin Rekomandues të Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin trajtohet kërkesa për inicim të procedurës për shitje direkte të pronës/sipërfaqes të cekur në dispozitiv të këtij vendimi për pronën e NSh KBI Progres – Lavertari Blegtori me parashtruesin dhe të tjerët.

Raporti Rekomandues i është prezantuar Bordit të Drejtorëve për vendosje meritore, në pajtim me kompetencat e tij të parapara me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, si dhe Rregulloren Nr. 08/2025 për Shitje Direkte të Aseteve të Caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.
Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit dhe Memorandumin e Divizionit për Shitje Direkte, në të cilin propozohet korrigjimi i vendimit të Bordit Nr. Ref. BD-235/28 për palën

Bordi pati parasysh faktet si në vijim:
Bordi i Drejtorëve me vendimin nr. ref. BD-235/28, të datës 29 korrik 2026 kishte miratuar raportin përfundimtar për shitjen e ngastrës kadastrale. Në vendimin në fjalë, është përvjedhur një lëshim teknik sa i përket numrit të ngastrës kadastrale nr. 657-2 në vend të nr. 657-7, gabim i cili tutje ka reflektuar në Vendimin nr. ref. BD-235/28 për miratimin e shitjes. Të gjitha aspektet tjera të Vendimit në fjalë në lidhje me këtë shitje nuk ka nevojë të ndryshohen dhe mbesin të njëjta. Duhet të theksohet, se të gjitha pagesat nga blerësja (shih shtojcën nr. 3) dhe procedurat në lidhje me këtë shitje direkte kanë përfunduar përbrenda Divizionit të Shitjes Direkte por nuk mund të procedohet tutje me nënshkrimin e kontratës për shkak të këtij gabimi teknik.

Bordi po ashtu pati parasysh nenin 15 paragrafin 2 të rregullores nr. 08/2025 "*për rishikimet dhe korrigjimet eventuale të kërkesave/vendimeve të cilat konsiderohen të korrigjueshme*".
Bordi shqyrtoi propozimin/rastin e paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Nr. Ref. BD-237/69

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit të Kërkesës për Përcaktimin e Statusit, sipas së cilit konstatohet se Ndërmarrja për Prodhimin dhe Shitjen e Gazrave Teknike "Tehnogas", Fabrika Kralevo – Aseti në Prishtinë, Kosovë, KPS1552/PRN215 si dhe çdo aset i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen, janë në pronësi shoqërore dhe bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare te Privatizimit.**

II. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesës për Përcaktimin e Statusit të Entitetit (SDR-KPS), ku pas shqyrtimit të lëndës për Ndërmarrjen për Prodhimin dhe Shitjen e Gazrave Teknike "Tehnogas", Fabrika Kralevo – Aseti në Prishtinë, Kosovë, KPS1552/PRN215 u konstatua se asetet e ndërmarrjes së lartcekur si dhe çdo aset tjetër i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen janë pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në përputhje me nenin 5.1.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Agjencia mund të ushtrojë autoritetin e saj për administrimin, shitjen apo likuidimin e pronave vetëm në rastet kur ndërmarrjet apo asetet përkatëse kanë status të pronës shoqërore.

Bazuar në dokumentet e lëndës, të dorëzuara në Njësinë për Regjistrimin e Ankesave në AKP në vitin 2008, në emër të ndërmarrjes "Messer Tehnogas" AD, Beograd, me adresë në Banjicki Put nr. 62, në cilësinë e pasardhësit ligjor të "Tehnogas" DD, Fabrika në Kralevo, me adresë në Izletnička nr. 45, rezulton se ndërmarrja "Tehnogas" është themeluar dhe ka funksionuar si Organizatë e Punës/OTHPB "Tehnogas" Beograd, status të cilin e ka mbajtur deri në vitin 1993. Pas vitit 1993, ndërmarrja ka pësuar ndryshime në statusin juridik, duke u transformuar në shoqëri aksionare me pronësi private. Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 463-5089/95-09, të datës 27.10.1995, Ndërmarrjes për Prodhimin dhe Shitjen e Gazrave Teknike "Tehnogas" Sh.A., Fabrika Kralevë, i është dhënë në shfrytëzim të përhershëm toka e pa ndërtuar ndërtimore, në pronësi të qytetit të Prishtinës, e regjistruar në fletën poseduese nr. 3838 për KK Prishtinë, parcela kadastrale nr. 1498/1, me sipërfaqe prej 0.25.38 ha, ndërtimit të lokaleve të specializuara, si dhe të depos për bombola dhe pajisje të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së ndërmarrjes, kundrejt kompensimit të përcaktuar me vendim., Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Prishtinës, nr.463-5089/95-09,me datë 03.11.1995 është lidhur Kontrata për kompensimin e tokës ndërtimore ndërmjet Fondit për Tokë Ndërtimore, Rrugë dhe Veprimtari Komunale të Qytetit të Prishtinës dhe ndërmarrjes "Tehnogas" Kralevo.

Palët kontraktuese janë dakorduar që ndërmarrjes "Tehnogas" t'i jepet në shfrytëzim të përhershëm toka ndërtimore, përkatësisht parcela kadastrale nr. 1498/1, në territorin e Komunës së Prishtinës, me sipërfaqe prej 0.25.38 ha, për ndërtimin e objekteve të specializuara për ruajtjen e bombolave dhe pajisjeve të tjera.

Bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 463-5089/95-09, të datës 27.10.1995, për dhënien në shfrytëzim të përhershëm të tokës ndërtimore të pa ndërtuar,

Shërbimi Kadastral i Paluajtshmërive, më datë 07.12.1995, ka nxjerrë Vendimin nr. 952-3-95/1402, për lejimin e ndryshimit të shfrytëzuesit në operatin kadastral të Komunës së Prishtinës. Me këtë vendim, është lejuar ndryshimi i shfrytëzuesit të paluajtshmërisë, të evidentuar në fletën poseduese nr. 3838, parcela kadastrale nr. 1498/1, me sipërfaqe prej 0.25.38 m², me kulturë "arrë", klasa 2, nga titullari Kuvendi Komunal i Prishtinës, në emër të ndërmarrjes "Tehnogas" Sh.A., Kraljevo.

Sipas raportit të gjeneruar nga shërbimet digjitale të Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK), të datës 08.09.2026, rezulton se parcela kadastrale P-71914059-01498-1, e ndodhur në vendin e quajtur "Livadhe", në Zonën Kadastrale Prishtinë, me sipërfaqe prej 2,538 m², është e evidentuar si pronë shoqërore dhe si tokë bujqësore, ndërsa në evidencat kadastrale figuron në posedim të Ndërmarrjes "Tehnogas" Kralevo.

Në përputhje me nenet 5, 6 dhe 15.2.17 të të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/70

Në bazë të neneve 5.12 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet Raporti Shqyrtues i Komisionit të Kërkesës për Përcaktimin e Statusit, sipas së cilit konstatohet se aseti në Kosovë i Organizatës Punuese Ndërtimore "RADAN", KPS1417/PRN121, Fabrika për Prodhimin e Tullave Shumëngjyrëshe, Dekoruese, Silikate, Gëlqerore, Fasadore dhe Tullave të Tjera, në Lebane, si dhe çdo aset i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen, janë në pronësi shoqërore dhe bien nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**

II. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi raportin e Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesës për Përcaktimin e Statusit të Entitetit (SDR-KPS), ku pas shqyrtimit të lëndës për asetin në Kosovë i Organizatës Punuese Ndërtimore "RADAN", KPS1417/PRN121, Fabrika për Prodhimin e Tullave Shumëngjyrëshe, Dekoruese, Silikate, Gëlqerore, Fasadore dhe Tullave të Tjera, në Lebane u konstatua se asetet e ndërmarrjes së lartcekur si dhe çdo aset tjetër i ndërmarrjes që do të identifikohet në të ardhmen janë pronësi shoqërore dhe bien nën juridiksionin administrativ të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Në përputhje me nenin 5.1.1.2 të Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Agjencia mund të ushtrojë autoritetin e saj për administrimin, shitjen apo likuidimin e pronave vetëm në rastet kur ndërmarrjet apo asetet përkatëse kanë status të pronës shoqërore.

Bazuar në dokumentet e lëndës, të shqyrtuara nga Komisioni për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjeve/Aseteve, kjo pas pranimit të Kërkesës për Përcaktimin e Statusit të Ndërmarrjes (në tekstin e mëtejmë: KPS) nga Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës AKP lidhur me lëndën Organizata Punuese Ndërtimore "RADAN" – Fabrika për Prodhimin e Tullave Shumëngjyrëshe, Dekoruese, Silikate, Gëlqerore, Fasadore dhe Tullave të Tjera, në Lebane, Serbi – Aseti në Dobratin, Kosovë, KPS1417/PRN121, ku sipas dokumentacionit rezulton se prona objekt i shqyrtimit ka fituar karakterin e pronës shoqërore përmes procedurës së ekspropriimit të zhvilluar në vitin 1988. Konkretisht, sipas Aktvendimit të Sekretariatit për Ekonomi pranë Komunës së Lipjanit, nr. 05.nr.465-1382, të datës 06.12.1988, të nxjerrë sipas kërkesës së Organizatës Punuese Ndërtimore "Radan" nga Lebane, Serbi, nr. 1265-465, të datës 25.10.1988, ishte kërkuar ekspropriimi i paluajtshmërisë me sipërfaqe prej 2.14.24 ha, për nevojat e ndërtimit të një reparti për prodhimin e tullave shumëngjyrëshe në Zonën Kadastrale Dobratin. Në mënyrë të veçantë, pika I e Aktvendimit përcakton shprehimisht se paluajtshmëria ekspropriohet me kompensim dhe "bartet në pronësi shoqërore në favor të OPN 'Radan' Lebane" për nevojat e ndërtimit të repartit për prodhimin e tullave shumëngjyrëshe. Për rrjedhojë, nga vetë përmbajtja e aktit juridik rezulton se efekti i ekspropriimit nuk ka qenë krijimi i pronës private në favor të OPN "Radan", por kalimi i paluajtshmërisë në regjimin e pronës shoqërore, me caktimin e OPN "Radan" si subjekt në favor të të cilit është bërë ky kalim. Po ashtu, sipas pikës II të të njëjtit Aktvendim, pronari i mëparshëm obligohej që tokën t'ia dorëzonte shfrytëzuesit të ri menjëherë pas plotfuqishmërisë së Aktvendimit, çka konfirmon përfundimin e procedurës së ekspropriimit dhe kalimin e të drejtave mbi paluajtshmërinë sipas përcaktimit të aktit.

Këto të dhëna mbështeten më tej nga Vërtetimi i Sekretariatit për Ekonomi – Shërbimi për Çështje Pronësore-Juridike, Kuvendi Komunal i Lipjanit, nr. 03-465-351, i datës 30.06.1989, i lëshuar me kërkesë të OPN "Radan" Lebane, në të cilin konfirmohet se janë zgjidhur të gjitha çështjet juridiko-pronësore lidhur me lokacionin për ndërtimin e fabrikës, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2.14.14 ha, se vendimet për ekspropriimin e tokës kishin marrë formë të prerë, si dhe se ishin zgjidhur çështjet e kompensimit të pronarëve të mëparshëm. Me këtë Vërtetim, gjithashtu, konfirmohet se nga data 19.04.1989, OPN "Radan" Lebane është evidentuar në lidhje me paluajtshmërinë e ekspropriuar.

Gjithashtu, nga Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, e datës 23.09.2026, rezulton se njësitë kadastrale nr. P-73409025-00385-5, 00385-6, 00386-2, 00387-2, 00388-2, 00389-2, 00390-2 dhe 00391-2, në Zonën Kadastrale Dobratin, Komuna e Graçanicës, evidentohen si "Pasuri Shtetërore KK Graçanicë", ndërsa Iloji i pronës është evidentuar shprehimisht si "pronë shoqërore".

Në rastin konkret, dokumentacioni i administruar krijon një vijimësi të qartë dokumentare dhe juridike të statusit të pronës: (i) Aktvendimi i vitit 1988 përcakton shprehimisht bartjen e paluajtshmërisë në pronësi shoqërore; (ii) Vërtetimi i vitit 1989 konfirmon përfundimin dhe plotfuqishmërinë e procedurës së ekspropriimit dhe zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe të kompensimit; dhe (iii) evidenca kadastrale e datës 23.09.2026 vazhdon ta evidentojë pronën si "pronë shoqërore".
Andaj në përputhje me nenet 5, 6 dhe 15.2.17 të të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (me ndryshime), dhe Ligjin 04/L-115) Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/71

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115 nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, Rregullore Nr. 01/2026 për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohen rekomandimet e komisionit vlerësues lidhur me dhënien me qira të aseteve të Ndërmarrjes "Jatex", me konkretisht njësinë nr.2, nr.3 dhe nr.4, duke marrë parasysh karakteristikat e aseteve, kushtet e tregut dhe vlerën aktuale të tregut për prona të ngjashme, çmimi i qirasë është i arsyeshëm dhe ekonomikisht i justifikueshëm.**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi materialin e prezantuar për këtë pikë, duke përfshirë propozimin e Komisionit për vlerësimin e qiradhënieve si dhe propozimin-rekomandimin nga Menaxhmenti sa i përket rezultateve/çmimeve të ofertimit nga qiradhënia e aseteve të datës 28 gusht 2026.

Mandati i AKP-së mes tjerash konsiston në ruajtjen dhe rritjen e vlerës së Ndërmarrjeve Shoqërore pa marrë parasysh a janë vendosur ndërmarrjet në likuidim apo jo me qëllim të gjenerimit të të hyrave për ndërmarrjet që janë nën administrimin e AKP-së.

Prandaj, dhënia eventuale me qira e aseteve në shtojcë do ti shërbente rritjes së të ardhurave të gatshme për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), fonde këto që do të mbahen në mirëbesim për të paguar shpenzimet, pagesat për kreditorëve dhe transferohen eventualisht në Buxhetin e Kosovës si përfitues i drejtpërdrejtë/indirekt i të hyrave nga inkasimi i qirave.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi..

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/72

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023), Rregullorja Nr. 01/2026 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Rregullorja 05/2025 e Administrimit Direkt, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë respektivisht bëhet zëvendësimi /ndryshimi i subjektit qiramarrës kontraktues në kontratën e qirasë për shfrytëzimin e lokalit afarist në Gjakovë, me sipërfaqe prej 124 m², nga subjekti "Benita Group" sh.p.k. në subjektin "Benita Home Concept" sh.p.k., me efekt nga data 1 shtator 2026 për asetin e NSh Jatex.**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e transferit te qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim:

Më datë 1 shtator 2026, qiramarrësi "Benita Group" sh.p.k., (me numër te biznesit 811465716) i cili ka në shfrytëzim me qira lokalin afarist nr. 1, me sipërfaqe prej 124 m², në pronësi të Ndërmarrjes "Jatex" në Gjakovë, dhe me qira mujore në vlerë prej 548.01 euro, ka paraqitur kërkesë për ndryshimin e subjektit qiramarrës në kontratën ekzistuese të qirasë.
Kërkesa konsiston në kalimin e kontratës së qirasë nga subjekti "Benita Group" sh.p.k. në subjektin "Benita Home Concept" sh.p.k., (me numër te biznesit 812458637) ndërsa Drejtori Menaxhues dhe personi i autorizuar mbeten të njëjtë.

Ndryshimi ndërmjet dy subjekteve afariste ka të bëjë me strukturën e pronësisë, përkatësisht me aksionarët e shoqërive. Në subjektin "Benita Group" sh.p.k., aksionar i vetëm ka qenë Granit Bordoniqi, ndërsa në subjektin "Benita Home Concept" sh.p.k., kapitali aksionar është i ndarë në mënyrë të barabartë, me nga 50% të aksioneve, ndërmjet Arb Bordoniqit dhe Benita Muhaxherit, të cilët janë vëlla dhe motër.

Sipas kërkesës së qiramarrësit, arsyeja e ndryshimit të kontratës së qirasë ndërlidhet me riorganizimin e aktivitetit afarist të subjektit "Benita Group" sh.p.k., në kuadër te të cilit aktiviteti biznesor do të vazhdojë të ushtrohet përmes subjektit "Benita Home Concept" sh.p.k., me numër biznesi 812458637, ku Drejtor Menaxhues dhe person i autorizuar do të jetë i njëjtë z. Granit Bordoniqi. Drejtori Menaxhues i Ndërmarrjes Jatex ka aprovuar kërkesën e qiramarrësit të datës 1 shtator 2026, duke arsyetuar se qiramarrësi "Benita Group" sh.p.k. ka qenë korrekt në përmbushjen e obligimeve kontraktuese ndaj qiradhënësit.

Sipas vlerësimit të Menaxhmentit, transferimi i Kontratës së Qirasë sipas nenit 2.5 i Kontratës së Qirasë në mes të "NSh Jatex" dhe "Benita Group" do të mundësonte vazhdimin e inkasimit te pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, mundëson vazhdimin e aktivitetit afarist, duke ruajtur stabilitetin kontraktual dhe rrit potencialin për gjenerimin e të hyrave të qëndrueshme dhe maksimizimin e vlerës së asetit të Ndërmarrjes Shoqërore.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/73

Në bazë të nenit 6.1.14 dhe nenit 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023), Rregullorja Nr. 01/2026 për Qiradhënien e Aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore, Shtojca e Ligjit Nr. 04/L-034, Udhëzimi Ligjor i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme C-IV-25-0068 i dt. 19.11.2025, Neni 2.5 i Kontratës së Qirasë me nr. protokolli 20778/2025 e dt. 30.07.2025 dhe Neni 127 i Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet transferimi i Kontratës së Qirasë nga qiramarrësi zëvendësimi/ ndryshimi i qiramarrësit person fizik Nermine Sahatqiu (Letërnjoftimi Nr. 1233208368) tek personi juridik NAR Silver SHPK në Mitrovicën Veriore me përfaqësues Nermine Sahatqiu dhe Merita Sahatqiu, për hapësirën afariste për lokalin e ashtuquajtur Turist i NSh Trepça Standard në Veri të Mitrovicës, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën bazë.**

II. **Vendimi hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit për aprovimin e transferit te qirave sipas dispozitivit të këtij vendimi. duke u bazuar në faktet si në vijim:

Ndërmarrja Shoqërore "Trepça Standard", në Mitrovicë veriore – MIT082, është në proces të tranzicionit dhe është një prej njësive jo-thelbësore të KXMK Trepça, e cila sipas Ligjit nr. 05/L-120 për Trepçën, mbetet në administrim të AKP-së dhe e njëjta posedon disa asete për të cilat AKP fokusohet kryesisht në ruajtjen dhe qiradhënien e tyre. Njëri prej aseteve është lokali afarist "Turist" i cili gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 76 (në sheshin e qytetit), Mitrovicë veriore, me sipërfaqe të përgjithshme prej 28.4 m2. Më përpara, kjo pronë ka qenë e shfrytëzuar nga individë të panjohur të cilëve ndërmarrja Trepça – Menaxhmenti Serb në veri e kishte lëshuar me qira. Që nga fillimi i vitit 2025 lokali "Turist" ishte gjetur i zbraztë dhe është marrë në administrim nga AKP.

Me vendimin e Bordit nr. Ref BD-977/2025 i datës 16 Qershor 2025, aseti i "Trepça Standard", respektivisht lokali afarist "Turist" i cili gjendet në Rr. Mbreti Petar I nr. 76 është dhënë me qira znj. Nermine Sahatqiu për zgjerimin e veprimtarisë së saj afariste në veri të Kosovës. AKP ZR ne Mitrovice ka kërkuar nga qiramarrësi që kjo kontratë të transferohet nga personi fizik tek personi juridik, sipas rregullores së AKP-së, respektivisht transferi nga Nermine Sahatqija te personi jurdik "" NAR Silver" SHPK.pdf" SH.P.K. ne Mitrovicën Veriore, ku Nermine Sahatqiu është bashkëpronar.

Sipas vlerësimit të Menaxhmentit, transferimi i Kontratës së Qirasë do të mundësonte vazhdimin e inkasimit të pandërprerë dhe të sigurt të hyrave, duke marrë gjithashtu për bazë se qiramarrësit aktual nuk kanë ndonjë borxh të papaguar të qirasë. Kjo kontratë që nga koha e lidhjes është vazhduar pa ndërprerje deri me sot, si dhe qiramarrësi ka qenë i rregullt me pagesa dhe nuk ka borxh ndaj NSh-së.

Duke marr parasysh të gjitha, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/74

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PRN098 – Mekanizimi (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumë prej 3,500.00€, përkatësisht në kodin buxhetor e38 – Tatimi i korporatës.**

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN098 – Mekanizimi.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet si tatimi i korporatës, pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh PRN098 – Mekanizimi. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/75

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PRN080 – NSh Kosovatex (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumën totale prej 3,000.00 €, përkatësisht në kodet buxhetore si më poshtë:**
e30 – Uji në vlerë prej 100.00 €;
e31 – Energjia elektrike në vlerë prej 100.00 €;
e32 – Mbeturinat në vlerë prej 100.00 €;
e19 – Tatimi në të Ardhurat Personale për Ofruesit e Shërbimeve në vlerë prej 400.00 €;
e35 – Tatimi i paguar për qiranë e pranuar në vlerë prej 300.00 €;
e36 – Tatimi në Pronë (Komunës) në vlerë prej 1,000.00 €;
e38 – Tatimi i korporatës në vlerë prej 1,000.00 €.

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN080 – Kosovatex.
Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet si për ujë, energjia elektrike, mbeturinat, tatimi në të ardhurat personale për Ofruesit e Shërbimeve, tatimi i paguar për qiranë e pranuar; tatimi në pronë (Komunës) si dhe tatimi i korporatës, pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh PRN080 – Kosovatex. Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/76

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PRN064 – Lidhja Auto-Moto e Kosovës (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumën totale prej 2,500.00 €, përkatësisht në kodet buxhetore si më poshtë:**
e36 – Tatimi në Pronë (Komunës) në vlerë prej 500.00 €;
e38 – Tatimi i korporatës në vlerë prej 2,000.00 €.

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN064 – Lidhja Auto-Moto e Kosovës (në likuidim).

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet si për tatimin në pronë (Komunës) si dhe tatimi i korporatës, pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh PRN064 – Lidhja Auto-Moto e Kosovës (në likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/77

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PRN091 – Duhani (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumën totale prej 9,000.00 €, përkatësisht në kodin buxhetor e38 – Tatimi i korporatës.**

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

p

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të NSh PRN091 – Duhani (në likuidim).
Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet si për tatimin e korporatës, pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh PRN091 – Duhani (në likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/78

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 i ndryshuar me Ligjin Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin nr. 06/L-023, , nenit 2 dhe nenit 3.6.5 të Rregullores nr. 08/2023 për Politikat dhe Procedurat e Likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datën me 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet propozimi për rritjen e buxhetit të likuidimit për PRN177 – Agrobisernica (në likuidim) që konsiderohet i domosdoshëm për finalizimin e procesit të likuidimit në shumën totale prej 6,200.00 €, përkatësisht në kodet buxhetore si më poshtë:**
   e18 – Ofruesit e Shërbimeve (pagesat NETO) në vlerë prej 4,000.00 €;
   e19 – Tatimi në të Ardhurat Personale për Ofruesit e Shërbimeve në vlerë prej 1,200.00 €;
   e38 – Tatimi i korporatës në vlerë prej 1,000.00 €.

II. **Autorizohet Departamenti i Buxhetit dhe Financave të AKP-së të përfshijë ndryshimet e miratuara buxhetore për Ndërmarrjen Shoqërore nga pika (I) e këtij vendimi.**

III. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për Rritja e buxhetit të likuidimit të PRN177 – Agrobisernica (në likuidim).

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit dhe analizimit të dokumentacionit relevant, ka konstatuar që ende nevojitet buxhet për shpenzimet si për pagesën e ofruesve të shërbimeve, tatimit në të ardhurat personale për OSh-ët, tatimin e korporatës, pasi që ende nuk kanë përfunduar procedurat e likuidimit NSh PRN177 – Agrobisernica (në likuidim). Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:
Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/79

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme plotësuese/shtesë të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Gërmia PRN093 nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale 29,901.40 € për një 47 kreditor të ndarë në 62 transaksione.**

II. **Vendimihyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme plotësuese/shtesë për kreditorët e NSh Gërmia PRN093 nga Rajoni i Prishtinës sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Ky vendim u miratua duke pas parasysh se Në raportin e shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në qershor 2017 nuk janë përfshirë kreditorët që janë përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye se të njëjtat janë aprovuar më vonë me vendimin e DhPGjSK-së pas ankesës nga pala ndaj vendimit të AL-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar, në rast nevoje dhe në mungesë të mjeteve, Autoriteti i Likuidimit parashtron kërkesat tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe kjo pagesë e institucionit përgjegjës do të mbulojë pagesat e kreditorëve, dhe në të njëjtën kohë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme plotësuese/shtesë të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Gërmia PRN093 nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/80

Në bazë të nenit 15.2.7 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 të ndryshuar me Ligjin 04/L-115, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 06/L-023 neneve 41.3 dhe 42 të Shtojcës së të njëjtit ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet kërkesa për shpërndarjen e përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Tregtia e Kosovës PRN102 nga Rajoni i Prishtinës në shumën totale 48,499.90 € për një 1 kreditor të ndarë në 2 transaksione.**

II. **Vendimi hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi sipas procedurave ka shqyrtuar propozimin nga Autoriteti i Likuidimit për aprovim e shpërndarjes të përkohshme plotësuese për kreditorët e NSh Tregtia e Kosovës PRN102 nga Rajoni i Prishtinës sipas nenit 41.3 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Ky vendim u miratua duke pas parasysh se në raportin e shpërndarjes së përkohshme të paraqitur në shtator 2016 në mbledhjen e 81-të nuk ishte përfshirë kreditori që është përfshirë në shtojcën 3 të këtij raporti të shpërndarjes, për arsye se e njëjta është aprovuar më vonë me vendimin e DhPGjSK-së pas ankesës nga pala ndaj vendimit të AL-së.

Autoriteti i Likuidimit pas shqyrtimit të çdo kërkese dhe verifikimit të listës së ankesave në DhPGjS, dhe po ashtu shqyrtimit të analizave përmbledhëse të hyrave dhe shpenzimeve, rezervimet e nevojshme për ankesat e parashtruara si dhe duke analizuar çdo dokument apo të dhënë relevante ka konstatuar, në rast nevoje dhe në mungesë të mjeteve, Autoriteti i Likuidimit parashtron kërkesat tek institucionet përgjegjëse që të bëjnë bartjen e fondeve nga procedura e shpronësimit dhe kjo pagesë e institucionit përgjegjës do të mbulojë pagesat e kreditorëve, dhe në të njëjtën kohë do të ekzistojnë fonde të mjaftueshme për Raportin e Shpërndarjes të Përkohshme plotësuese të fondeve të likuidimit për kreditorët e NSh Tregtia e Kosovës PRN102 nga Rajoni i Prishtinës.

Për këtë arsye, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pa kënaqur me këtë vendim mund të parashtrojë padi pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme brenda afatit prej 30 ditësh.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. Ref. BD-237/81

Në bazë të neneve 6.1.1, 6.1.2 dhe 15.2.4 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar me Ligjin 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), Rregullores nr. 07/2025 për Administrimin Direkt dhe Shtojcës së kësaj Rregulloreje, nr. 1 për NSh "Inex Sharr Planina" – Qendra e Skijimit Brezovicë, Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (për aq sa është i aplikueshëm), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare në mbledhjen e mbajtur me datë 29 shtator 2026 nxjerr këtë:

VENDIM

I. **Caktohet kompensimi mujor bruto i Kryesuesit të Bordit të Përkohshëm Menaxhues (BPM) të NSh Inex Sharr Planina Brezovica në shumën 700.00 €, i Zëvendës kryesuesit në shumën 670.00 € dhe i secilit anëtar tjetër të BPM-së në shumën 650.00 €.**
II. **Kompensimi sipas pikës 1 të paguhet nga buxheti i NSh "Inex Sharrplanina" – Qendra e Skijimit në Brezovicë, sipas procedurave financiare dhe akteve në fuqi.**
III. **Niveli i kompensimit të rishikohet pas përfundimit të sezonit dimëror 2026/2027, mbi bazën e vlerësimit të dokumentuar të performancës së Ndërmarrjes dhe angazhimit të BPM-së, duke marrë parasysh edhe faktorët objektivë që kanë ndikuar në operim.**
IV. **Nëse nga vlerësimi rezulton se performanca nuk ka shënuar përmirësim të arsyeshëm krahasuar me vitin 2025, Bordi i Drejtorëve mund të vendosë rikthimin e kompensimit në nivelin paraprak prej 650.00 € bruto për Kryesuesin dhe 600.00 € bruto për Zëvendëskryesuesin dhe anëtarët.**
V. **Menaxhmenti i AKP-së dhe njësitë kompetente obligohen të ndërmarrin veprimet administrative dhe financiare për zbatimin e vendimit dhe për përgatitjen e raportit të vlerësimit pas sezonit dimëror 2026/2027.**
VI. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**

ARSYETIM

Bordi shqyrtoi propozimin e Menaxhmentit të Agjencisë për përcaktimin, respektivisht rritjen e kompensimit të Bordit të Përkohshëm Mbikëqyrës të NSH "Inex Sharrplanina" – Qendra e Skijimit në Brezovicë.

Duke qenë se Bordi i ndërmarrjes është emëruar me datë 27.08 2026 përmes vendimit Nr. Ref. BD-236-5, dhe duke pas parasysh se me organizimin e ri të qeverisjes dhe mbikëqyrjes së Qendrës së Skijimit parashihet angazhim më intensiv i BPM-së, veçanërisht në shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e investimeve të planifikuara, realizimin e buxhetit dhe prokurimeve, përgatitjen dhe zhvillimin e sezonit dimëror, sigurinë dhe funksionimin e infrastrukturës së skijimit, si dhe monitorimin më të drejtpërdrejtë të performancës operative dhe financiare të Ndërmarrjes. Parashihen së paku dhjetë (10) mbledhje të rregullta gjatë vitit, krahas mbledhjeve shtesë dhe angazhimit të shtuar mbikëqyrës që mund të kërkohet nga organet kompetente të AKP-së. Duke marrë parasysh nivelin historik të kompensimit, shtimin e përgjegjësive dhe intensitetit të angazhimit, si dhe nevojën që kompensimi të mbetet proporcional me funksionin mbikëqyrës dhe mundësitë financiare të Ndërmarrjes, Menaxhmenti ka propozuar një rritje e moderuar, e shoqëruar me rishikim pas sezonit dimëror 2026/2027.
Pas përfundimit të sezonit dimëror 2026/2027, Menaxhmenti i AKP-së, në koordinim me njësinë kompetente, do të bëjë vlerësimin e performancës së Ndërmarrjes dhe angazhimit të BPM-së dhe t'i paraqesë Bordit të Drejtorëve raport dhe rekomandim për vazhdimin ose rishikimin e kompensimit.

Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike:

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Kundër këtij vendimi ankesa mund të paraqitet pranë organeve kompetente në afat prej tetë (8) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Prishtinë, më 29 shtator 2026.

Hekuran Nikçi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

Tel: +383 (0) 38 500 400
Faks: +383 (0) 38 248 076
Email: info@pak-ks.org
www.pak-ks.org
Rr. Dritan Hoxha, 55, Lakrishtë
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës